



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Bedri Hamza, Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut Vesa Broja, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Nga:	Erblin Hetemi, Ud. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL. Date: 26.09.2024 VI-020-586
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Sanije Dërguti, Zyrtar e Lartë për Monitorim të Komunave
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Mitrovicës së Jugut
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Mitrovicës së Jugut

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullosës (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr.02-060/01-0061628-5/24 për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company SH.P.K duke përfshi edhe objekti për banim/afarizëm

I miratuar më datë: 23.09.2024

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 25.09.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut në mbledhjen e mbajtur me datë 23.09.2024, ka miratuar Vendimin Nr.02-060/01-0061628-5/24 për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company SH.P.K duke përfshi edhe objekti për banim/afarizëm i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut.

MAPL, konstaton se Vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut është bazuar me nenin 12 dhe 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 24 dhe 25 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 29 dhe 31 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Vendim Nr.02-060/01-0061628-5/24 për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi Company SH.P.K duke përfshi edhe objekti për banim/afarizëm është miratuar në mbledhjen e Kuvendit me datë 23.09.2024, me 30 vota për dhe 0 kundër dhe 0 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Bedri Hamza, gradonačelnik opštine Južna Mitrovica Vesa Broja, predsedavajuća Skupštine opštine Južna Mitrovica	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumentavije u MALS-u Jedinica za administraciju dokumentacije u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a,	
Od:	Erbllin Hetemi, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Dana, 26.09.2024. Br-VI-020-586
Službenik-ca za procenjivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
Službenik-ca za izradu pravne procene:	Sanije Dërguti, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Južna Mitrovica	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine Južna Mitrovica	

Poštovani gradonačleniče,
Poštovana predsedavajuća,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opština, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju akata opština, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi sledeći opštinski akt:

Odluka br.02-060/01-0061628-5/24 o razmeni nepokretne imovine opštine sa nepokretnom privatnom imovinom u vlasništvu "Arsi Company SH.P.K" uključujući i objekat za stanovanje/poslovanje

Usvojena dana, 23.09.2024.

Podnešena na razmatranje u MALS-u dana, 25.09.2024.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je akt opštine u proceduralnom aspektu u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Objašnjenje

Skupština opštine Južna Mitrovica, na sednici održanoj dana, 23.09.2024. godine, usvojila Odluku br.02-060/01-0061628-5/24 o razmeni nepokretne imovine opštine sa nepokretnom privatnom imovinom u vlasništvu "Arsi Company SH.P.K" uključujući i objekat za stanovanje/poslovanje, doenta od strane Skupštine opštine Južna Mitrovica.

MALS, konstatuje da je odluka doneta od strane Skupštine opštine Južna Mitrovica, zasnovana na članu 12. i 14. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 24. i 25. Zakona br.06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, članu 29. i 31. Uredbe VRK br.09/2020 o utvrđivanju postupaka za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine.

Odluka br.02-060/01-0061628-5/24 o razmeni nepokretne imovine opštine sa nepokretnom privatnom imovinom u vlasništvu "Arsi Company SH.P.K" uključujući i objekat za stanovanje/poslovanje, usvojena je na sednici Skupštine opštine Južna Mitrovica dana, 23.09.2024. godine, sa 30 glasova "za" 0 "protiv" i 0 "uzdržanih".

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.